



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

**PËRMBLEDHJE E PROCESVERBALIT**

**PËR HEDHJEN E SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT  
TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI PËR VITIN 2020**

Nën drejtimin e Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta, **sot më datë 5 dhjetor 2019, ora 12.00**, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 403 datë 25.11.2019 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Presidenti i Republikës”, si dhe Vendimit nr. 404 datë 25.11.2019 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””, në selinë e Presidentit të Republikës, salla “Skënderbej”, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2020.

Shorti u hodh në prani të Avokatit të Popullit, zonjës Erinda Ballanca, e cila monitoroi procesin së bashku me përfaqësuesit e institucionit që drejton, Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zotit Gent Ibrahim, Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor zotit Maksim Qoku, përfaqësueses të Gjykatës Kushtetuese zonjës Olta Aliaj, të Ngarkuarës me Punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara zonjës Leyla Moses-Ones, përfaqësueses të Kuvendit të Shqipërisë, deputetes zonjës Klotilda Bushka, Kryetarit të Komisionit të Pavarur të Koordinimit, Monitorimit për zbatimin e ligjit nr.115/2016, pranë Kuvendit të Shqipërisë zotit Artan Spahiu, drejtueses së Seksionit Ligjor të Delegacionit të Bashkimit Europian zonjës Lenka Vitkova, etj.

Procesi i shortit u transmetua direkt e me transparencë të plotë nga Televizioni Publik Shqiptar dhe mediat e tjera të pranishme.

Në përfundim të hedhjes së shortit, rezultoi se anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, janë si vijon:

### **Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:**

1. Fiona Papajorgji Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
2. Vitore Tusha Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
3. Ardian Dvorani Gjyqtar i Gjykatës së Lartë
4. Arta Marku Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
5. Miranda Andoni Gjyqtar nga Gjykatat e Apelit
6. Saida Dollani Gjyqtar nga Gjykatat e Apelit
7. Ludovik Dodaj Prokuror nga zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
8. Fatjona Memçaj Prokuror nga zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apeli
9. Arjan Qafa Gjyqtar nga Gjykatat Administrative

### **Anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

1. Marsida Xhaferllari Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
2. Bilbil Mete Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme
3. Nazmi Troka Gjyqtar nga Gjykatat e apelit
4. Nezir Gjoka Prokuror nga zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
5. Marjana Velçani (Idrizi) Gjyqtar nga Gjykatat Administrative

Për shkak të mungesës së kandidatëve nga lista e dërguar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk ka anëtar zëvendësues.

Procedura e hedhjes së shortit u mbyll në datë 5 dhjetor 2019, ora 13.10

### **SEKRETARIA TEKNIKE**

Znj. Krisilda Fana

Znj. Xhensjana Vathi

Z. Andi Hasani